

### SHTOJCA 3

#### Formulari i kërkesës për vazhdimin e lejes mjedisore



Emri i kompanisë	<b>“ Agi - Dani ” SH.P.K.</b>
Lloji i veprimtarisë	<b>Sepserimin e rërës dhe zhavorit</b>
Vendi/Lokacioni ku zhvillon Veprimtarinë	<b>Domorovc, Komuna Ranillug</b>
Emri, mbiemri dhe nënshkrimi i personit përgjegjës i kompanisë	<b>Rexhep Veseli, Drejtor</b>
Adresa	<b>Rr. Rexhep Mala, Nr:34</b>
Telefoni, fax, e-mail	<b>+383 44 575 736, <a href="mailto:agi-danishpk@hotmail.com">agi-danishpk@hotmail.com</a></b>
Emri dhe mbiemri i personit kontaktues përgjegjës për mjedis	<b>Halit Bajraliu</b>
Adresa	<b>Rr. Rexhep Mala, Nr:34</b>
Telefoni, fax, e-mail	<b>+383 44 575 736, <a href="mailto:agi-danishpk@hotmail.com">agi-danishpk@hotmail.com</a></b>
Numri i vendimit të Lejes Mjedisore Paraprake	<b>2690-2/21, dt. 09.02.2021</b>
Përshkrimi i dokumentacionit bashkangjitur kërkesës, përfshirë numrin e protokollit të dokumentit, datën e lëshimit dhe skadimit	<b>1. Certifikata e regjistrimit të Biznesit me nr. Unik Identifikues: 810272526, 04.10.2006 2. Leja Mjedisore me nr. 2690-2/21, dt. - dt. 09.02.2021, Leja Mjedisore është dhënë me afat prej 5 viteve dhe skadon me datë 09.02.2026, 3. Formulari i plotësuar sipas kushteve në shtojcën 2,</b>
Fatura e pagesës së tarifës për vazhdimin e Lejes Mjedisore	<b>Po</b>
Vlera financiare investuese e projektit (në euro)	<b>97,500.00 €</b>
Pesë(5) kopje fizike dhe një (1) elektronike (CD)	<b>Po</b>

## Shtojca 2

### Aplikacion për dhënien e lejes mjedisore

APLIKACION PËR DHËNJEN E LEJËS MJEDISORE		
<b>1. TE DHËNAT E PËRGJITHSHME</b>		
<b>1.1. Të dhënat për Operatorin</b>		
1.1.1.	Emri i subjektit	“ Agi - Dani ” SH.P.K.
	Vendi	Domorovc, komuna Ranillug
	Adresa	<b>Rr. Rexhep Mala, Nr:34</b>
	Nr. i tel./fax	+383 575 736
	E-mail	<a href="mailto:agi-danishpk@hotmail.com">agi-danishpk@hotmail.com</a>
1.1.2.	Numri i regjistrimit të biznesit, data e regjistrimit	810272526, Data e regjistrimit – 04.10.2006
1.1.3.	Personi Përgjegjës i kompanisë	Rexhep Veseli
	Nr. i tel./fax	+383 44 575 736
	E-mail	<a href="mailto:agi-danishpk@hotmail.com">agi-danishpk@hotmail.com</a>
<b>1.2. Të dhënat për impiantin</b>		
1.2.1.	Emri i impiantit	“Agi - Dani” Sh.P.K. – Impianti për seperimi të rërë dhe zhavorrit
1.2.2.	Adresa e lokacionit të impiantit	Domorov, komuna Ranillug

## 2. TË DHËNAT PËR LOKACIONIN E IMPIANTIT

<p>2.1.</p>	<p>Të dhënat për lokacionin ku zhvillohet veprimtaria sipas hartës së bashkangjitur</p>	<p>Lokacioni i impiantit të seperimit të rërës dhe zhavorrit ndodhet në fashatin Domorovc komuna e Ranillugës</p> 
<p>2.2.</p>	<p>Numri kadastral i parcelës</p>	<p>Impiani i seperimit të rërës dhe zhavorrit gjendet në Zonën Kadastrale Domorovc, në Komunën e Rabillugës, përkatësisht në parcelat kadastrale me numrat P-73507029-01766-0.</p> 
<p>2.3.</p>	<p>Përshkrimi i lokacionit të gjitha objektet dhe aktivitetet e tyre në atë zonë</p>	<p>Zona ku ndodhet impianti për separimin e rërës dhe zhavorrit të investitorit <b>Agi-Dani Sh.p.k.</b>, në fshatin Domorovc, Komuna e Ranillugut, përfaqëson një hapësirë me përdorim të konsoliduar afarist dhe infrastrukturor. Në afërsi të lokacionit ndodhen disa subjekte afariste dhe objekte infrastrukturore. Në një</p>

distancë prej rreth 275.8 m nga impianti ndodhet Fama Petrol, në distancë rreth 378.3 m gjendet Albina Petrol, në distancë prej rreth 574.9 m ndodhet kompania Brickos Sh.p.k., ndërsa në distancë rreth 752.2 m nga lokacioni gjendet Terminali Doganor.




Sa i përket zonave të banimit, distanca më e afërt e impiantit nga objektet rezidenciale është rreth 655 m, çka tregon se impianti është i ndarë nga vendbanimet me një hapësirë të konsiderueshme. Kjo distancë kontribuon në zvogëlimin e ndikimeve të mundshme mjedisore ndaj popullatës përreth




2.4. Të dhënat lidhur me florën dhe fauna në atë lokacion


Territori i komunës karakterizohet nga peizazh rural me dominim të sipërfaqeve bujqësore, zona me vegjetacion natyror dhe korridore përgjatë rrjedhave ujore. Këto kushte krijojnë baza për zhvillimin e florës dhe faunës tipike për këtë zonë. Flora përbëhet kryesisht nga bimësi natyrore dhe gjysmë-natyrore. Në zonat pranë rrjedhave ujore dhe tokave të lagështa është e pranishme bimësi ripariante, ndërsa në terrenet bujqësore dhe përreth tyre

		<p>gjenden livadhe natyrore dhe bimësi barishtore. Në zonat kodrinore dhe në pjesët me mbulesë drunore hasen lloje drurësh gjetherënës dhe shkurre karakteristike për këtë rajon, si lisi, ahu, shkoza, frashëri, si dhe bimësi shoqëruese barishtore dhe shkurrore. Fauna përfaqësohet nga specie të zakonshme të zonave rurale. Fauna tokësore përfshin gjitarë të vegjël dhe të mesëm, si lepuri i egër, dhelpra, iriqi dhe brejtës të ndryshëm. Fauna e shpendëve përbëhet nga shpezë të fushave, livadheve dhe zonave bujqësore, si dhe shpezë që lidhen me zonat me vegjetacion dhe ujëra sipërfaqësore. Në rrjedhat ujore dhe mjediset e lagështa janë të pranishme organizma ujorë, peshq dhe amfibë tipikë për kushtet lokale.</p>
2.5.	Të dhënat mbi zonat e veçanta të mbrojtura	<p>Në afërsi të impiantit ekzistues për separimin e rërës dhe zhavorrit të investitorit <b>Agi-Dani Sh.p.k.</b>, në fshatin Domoroc, Komuna e Ranillugut, nuk janë evidentuar zona të veçanta të mbrojtura me status ligjor të mbrojtjes së natyrës. Megjithatë, në zonën përreth janë të pranishme disa elemente me rëndësi natyrore dhe kulturore. Në një distancë prej rreth 737.94 m nga impianti gjendet objekti fetar Kisha e Fjetjes së Virgjëreshës së Bekuar, e cila përfaqëson një vlerë kulturore dhe historike për zonën. Distanca ekzistuese siguron ndarje të mjaftueshme hapësinore ndërmjet impiantit dhe këtij objekti. Sa i përket elementeve hidrografike, në një distancë prej rreth 13.42 m nga impianti gjendet Lumi Krivarekë, ndërsa Lumi Morava e Binçës ndodhet në një distancë prej rreth 644.99 m. Prania e këtyre rrjedhave ujore përbën element të rëndësishëm natyror të zonës dhe merret parasysh në kuadër të vlerësimit mjedisor dhe masave për parandalimin e ndotjes dhe mbrojtjen e ujërave sipërfaqësore.</p> 

### 3. PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE MBI VEPRIMTARINË

#### 3.1. Përshkrim i aktivitetit për të cilën kërkohet Leja Mjedisore

3.1.1.	Skema e procesit teknologjik	<p style="text-align: center;">SKEMA E PROCESIT TEKNOLOGJIK TË IMPIANTIT PËR SEPARIMIN E RËRËS DHE ZHAVORRIT</p> 
3.1.2.	Përshkrim i pajisjeve dhe fazat e procesit teknologjik	<p>Procesi teknologjik bazohet në ndarjen granulometrike të materialit. Impianti përbëhet nga pajisjet dhe makineritë në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ bunker pranues për pranimin e materialit inert,</li> <li>➤ shiritat transportues për bartjen e materialit ndërmjet fazave të procesit,</li> <li>➤ sitë vibruese për ndarjen e materialit sipas madhësisë së kokrrizave,</li> <li>➤ konstruksione mbështetëse për sitat dhe shiritat transportues,</li> <li>➤ hapësira të përcaktuara për deponimin e fraksioneve të ndara,</li> <li>➤ pajisje ndihmëse për furnizim me energji elektrike dhe kontroll të procesit.</li> </ul> <p>Procesi teknologjik zhvillohet në disa faza të njëpasnjëshme.</p> <p>Në fazën e parë, materiali inert (rërë dhe zhavorr) silllet në impiant dhe shkarkohet në bunkerin pranues. Kjo fazë përfshin vetëm pranimin dhe orientimin e materialit drejt linjës së përpunimit. Në fazën e dytë, materiali bartet përmes shiritave transportues drejt sitës vibruese, ku realizohet ndarja e materialit sipas madhësisë së kokrrizave. Në këtë fazë përfitohen fraksionet <b>0–4 mm</b>, <b>4–8 mm</b>, <b>8–16 mm</b> dhe <b>16–22 mm</b>, në varësi të hapjeve të sitave të përdorura. Në fazën e tretë, secili fraksion i ndarë bartet përmes shiritave transportues të veçantë dhe depozitohet në deponi të ndara sipas madhësisë granulometrike, duke ruajtur cilësinë e materialit dhe duke mundur mundësinë e menaxhimit të rregullt të produkteve të përfituara.</p> <p>Procesi teknologjik zhvillohet në mënyrë të vazhdueshme dhe të kontrolluar, pa gjeneruar mbetje të rrezikshme.</p>

		
3.1.3.	Numri i orëve të punës dhe ditëve të punës gjatë javës për kryerjen e aktiviteteve	<p>Hënë – Premte</p> <p>Orari i punës 08:00 – 17:00h</p> <p>E shtune</p> <p>Orari i punës 08:00 – 14:00h</p>
3.1.4.	Kapaciteti i projektuar dhe kapaciteti i realizuar, ditor, mujor, vjetor	<p>Kapaciteti i seperimit të rërës dhe zhavorrit është 80m<sup>3</sup>/orë,</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kapaciteti ditor: 80* 8 =640m<sup>3</sup>/ditë</li> <li>• Kapaciteti mujor: 640*26=16640m<sup>3</sup>/muaj</li> <li>• Kapaciteti vjetor: 16640*12=199680m<sup>3</sup>/vit</li> </ul>
3.1.5.	Të dhënat për shfrytëzimin e lëndës së parë dhe lendeve ndihmëse.	<p>Lënda e parë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Rëra dhe Zhavorri</li> </ul> <p>Lëndë ndihmëse:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Uji</li> </ul>

		<ul style="list-style-type: none"> <li>• Energjia Elektrike</li> </ul>
3.1.6.	Lista e rezervuarv edhe kapaciteti i tyre	Kompania “Agi - Dani”SH.P.K. nuk posedon rezervuar të lëndëve djegëse pasi mjetet e transportit furnizohen nga pompat e derivateve
3.1.7.	Lista e legjislacionit në fuqi	<p>Lista e Ligjeve dhe rregulloreve,</p> <p>Për plotësimin e formularit për vazhdimin e Lejes Mjedisore për impiantin e seperimit të rërës dhe zhavorrit nga kompania “Agi - Dani”SH.P.K., janë marre parasysh këto ligje:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025</li> <li>• Ligji për Mbeturina Nr. 04/L-060</li> <li>• Ligji Nr. 08/L-025 për mbrojtjen e ajrit nga ndotja</li> <li>• Ligji për VNM Nr. 08/L181</li> <li>• Ligji për mbrojtjen nga Zhurma Nr. 02/L-102</li> <li>• Ligji Nr. 08 për mbrojtjen nga zjarri</li> <li>• Ligji për mbrojtjen e natyrës Nr.03/L-233</li> <li>• Ligji për ujërat e Kosovës Nr. 04/L-147</li> </ul> <p>Udhëzimet Administrative:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Udhëzim Administrativ nr.04/2022 për Leje Mjedisore</li> <li>• Udhëzim Administrativ (mmphi) nr. 01/2025 për ndryshimin dhe plotësimin e udhëzimit administrativ (mmphi) nr. 04/2022 për leje mjedisore</li> <li>• Udhëzimi administrativ- nr. 13/2013 Për katalogun Shtetëror të mbeturinave</li> <li>• Udhëzimit Administrativ nr. 06/2021 mbi rregullat dhe normat e shkarkimeve në ajër nga burimet e palëvizshme të ndotjes.</li> </ul>
<b>3.2. Menaxhimi i Mbrojtjes së Mjedisit</b>		
	Sistemi menaxhues i mbrojtjes së Mjedisit	Sistemi i menaxhimit mjedisor është instrumente qe përcakton përgjegjësitë mjedisore për secilin anëtar apo punonjës të objektit, duke i ndihmuar ata të kuptojnë ndikimet mjedisore të shkaktuara nga aktivitetet apo veprimtaritë e tyre, si edhe të përcaktojnë objektivat mjedisore për të ulur ndikimet dhe për të përmirësuar performancë e tyre mjedisore. Sistemi i menaxhimit mjedisor paraqitet në forma të ndryshme dhe është ajo pjese e sistemit të përgjithshëm të administrimit, që përfshin strukturën organizative, aktivitetet e planifikuara,

3.2.1		<p>përgjegjësitë, praktik, procedurat dhe burimet për zhvillimin, zbatimin, arritjen, shqyrtimin dhe konsolidimin e praktikave mjedisore. Impianti i seperimit të rërës dhe zhavorrit “Agi - Dani” SH.P.K është e përkushtuar më të gjitha funksionet e sajë organizative në përmirësimet e vazhdueshme që të përmbushë të gjitha detyrimet ligjore për të pasur një Mjedistë pastër dhe të qëndrueshëm.</p> <p>Sistemet e Menaxhimit Mjedisor bazuar në ISO 14001 japin mundësinë e identifikimit, vlerësimit dhe menaxhimit të aspekteve mjedisore të një organizate me synim:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Respektimin e legjislacionit vendor</li> <li>• Përmirësimin e komunikimit me autoritetet</li> <li>• Parandalimin e dëmtimit të Mjedisit</li> <li>• Përmirësimin e vazhdueshëm i Mjedisit</li> </ul>
3.2.2	Raportimi	

#### 4. AJRI DHE NDRYSHIMET KLIMATIKE

4.1.	Pikat e burimit të emisioneve ematerieve ndotëse	<p>Gjatë funksionimit të impiantit për separimin e rërës dhe zhavorrit të investitorit <b>Agi-Dani Sh.p.k.</b>, emisionet në ajër janë të natyrës fizike dhe lidhen kryesisht me gjenerimin e pluhurit mineral dhe emetimin e gazrave nga mjetet transportuese.</p> <p>Pikat kryesore të burimit të emisioneve në ajër janë si në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• zona e pranimit dhe shkarkimit të materialit inert në bunkerin pranues, ku gjatë derdhjes së materialit mund të gjenerohet pluhur;</li> <li>• shirita transportues, veçanërisht në pikat e transferimit të materialit, ku për shkak të lëvizjes së materialit krijohen grimca pluhuri;</li> <li>• sita vibruese, ku gjatë procesit të ndarjes granulometrike lirohen grimca të imëta të materialit;</li> <li>• zonat e deponimit të fraksioneve të ndara, ku gjatë grumbullimit dhe manipulimit të materialit mund të krijohet pluhur;</li> <li>• lëvizja e mjeteve të rënda dhe automjeteve transportuese brenda hapësirës së impiantit, e cila kontribuon në ngritjen e pluhurit nga sipërfaqet e pambuluara;</li> </ul>
------	--	--

		<ul style="list-style-type: none"> <li>Eskavatorët, ngarkuesit frontalë dhe kamionët që operojnë brenda impiantit lëshojnë gazra djegieje të motorëve me naftë si CO<sub>2</sub>, CO, NO<sub>x</sub>, SO<sub>2</sub></li> </ul> <p>Emisionet e gjeneruara janë të karakterit difuz dhe të përkohshëm dhe varen nga intensiteti i punës, kushtet meteorologjike dhe mënyra e menaxhimit operacional. Ato menaxhohen përmes zbatimit të masave teknike dhe organizative për zvogëlimin e pluhurit dhe emisioneve në ajër, në përputhje me kërkesat mjedisore në fuqi.</p>
4.2.	Ndikimi i materieve ndotëse në cilësinë e ajrit	<p>Aktiviteti i impiantit për separimin e rërë dhe zhavorrit shkakton vetëm emetime me karakter pluhuri gjatë manipulimit të rërë dhe zhavorrit. Pluhuri gjenerohet kryesisht në fazat e shkarkimit të materialit, sitjes dhe transportit të brendshëm përmes shiritave transportues. Ky pluhur përbëhet nga rërë dhe zhavorri dhe shpërndahet kryesisht në zonën e afërt të punës. Ndikimi i pluhurit në cilësinë e ajrit është i lokalizuar dhe i përkohshëm, duke u kufizuar në hapësirën e impiantit dhe zonën përreth tij. Emisionet e pluhurit kontrollohen përmes zbatimit të masave teknike dhe operative, përfshirë lagjen periodike të sipërfaqeve të punës dhe rrugëve të brendshme, mirëmbajtjen e rregullt të sipërfaqeve. Procesi teknologjik nuk përfshin djegie industriale dhe nuk prodhon gazra apo ndotës të tjerë atmosferikë. Duke marrë parasysh karakterin inert të materialit, distancën prej rreth <b>655 m</b> nga objektet më të afërta të banimit dhe zbatimin e masave të kontrollit, ndikimi i përgjithshëm i aktivitetit në cilësinë e ajrit vlerësohet i ulët dhe i pranueshëm nga pikëpamja mjedisore.</p>
4.3.	Burimet difuzive të emisioneve të materieve ndotëse	<p>Gjatë funksionimit të impiantit për separimin e rërës dhe zhavorrit, emisionet e materieve ndotëse në ajër paraqiten kryesisht në formë difuzive, si pasojë e proceseve mekanike të manipulimit të materialit. Këto emisione nuk burojnë nga pika të fiksuara me oxhaqe apo sisteme shkarkimi të centralizuara, por shpërndahen në mënyrë të përhapur brenda hapësirës së impiantit. Burimet kryesore difuzive të emisioneve përfshijnë zonat e shkarkimit të rërës dhe zhavorrit, pikat e transferimit të materialit përgjatë shiritave transportues, procesin e sitjes në sitat vibruese, si dhe zonat e deponimit të fraksioneve të ndara. Po ashtu, lëvizja e mjeteve të rënda dhe automjeteve transportuese në rrugët e brendshme të impiantit kontribuon në ngritjen e pluhurit nga sipërfaqet e pambuluara. Emisionet difuzive janë të karakterit pluhuror, përbëhen nga rëra dhe</p>

		zhavorri dhe janë të kufizuara kryesisht në zonën e punës. Intensiteti i tyre varet nga kushtet operative dhe meteorologjike, si dhe nga mënyra e menaxhimit të aktiviteteve. Me zbatimin e masave teknike dhe organizative për kontrollin e pluhurit, ndikimi i këtyre burimeve difuzive në cilësinë e ajrit mbetet i ulët dhe i lokalizuar.
4.4.	Pajisjet për trajtimin e gazrave shkarkuese	Nuk janë të nevojshme tek impianti i seperimit të rërës dhe zhavorrit.
4.5.	Pajisjet për de-pluhurim	Nuk posedon pajisjet për De-pluhurin.
4.6.	Monitorimi i emisioneve	Sipas kushteve të dala nga leja mjedisore, bënë monitorimin e emisioneve.
4.7.	Monitorimi i Emisioneve /cilësisë së ajrit	Sipas kushteve të dala nga leja mjedisore, bënë monitorimin e emisioneve.
4.8.	Raportimet	Sipas kushteve të dala nga leja mjedisore, bënë raportimet, 1 herë në vit.
4.9.	Masat për zvogëlimin e ndotjes së ajrit	<p>Për të ulur pluhurin dhe gazrat që krijohen gjatë punës së impiantit të seperimit të rërës dhe zhavorrit, zbatohen këto masa:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Ujitja e sipërfaqeve të punës</b> - Sipërfaqet ku lëvizin makineritë dhe zonat ku ngarkohet e shkarkohet materiali spërkaten sipas nevojës për të ulur pluhurin. Uji sigurohet nga cisterne.</li> <li>• <b>Mbulimi i pikave ku materiali bie</b> - Pikat ku materiali bie nga një rrip në tjetrin ose nga rripi në sitë mbulohen për të penguar shpërndarjen e pluhurit.</li> <li>• <b>Kufizimi i shpejtësisë së mjeteve</b> - Makineritë dhe kamionët lëvizin me shpejtësi të ulët brenda impiantit për të mos ngritur pluhur të panevojshëm.</li> <li>• <b>Mirëmbajtja e makinerive</b> - Motorët e pajisjeve kontrollohen rregullisht për të ulur gazrat dhe tymrat gjatë punës.</li> <li>• <b>Pastrimi i rrotave të mjeteve</b> - Rrotat pastrohen para daljes nga impianti për të mos bartur pluhur dhe balte jashtë zonës së punës.</li> <li>• <b>Kufizimi i punës në erë të forte</b> - Gjatë periudhave me erë të fortë, puna kufizohet për të shmangur përhapjen e pluhurit në zonën përreth.</li> </ul>

4.10.	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ndryshimet klimatike	<p>Për të ulur ndikimet që lidhen me emetimin e gazeve serrë nga makineritë dhe pajisjet që përdoren në impiant, zbatohen këto masa:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Përdorimi i makinerive me efikasitet më të lartë</b> - Zgjedhja e mjeteve dhe pajisjeve me konsum më të ulët të karburantit ul sasinë e gazeve që lëshohen gjatë punës.</li> <li>• <b>Mirëmbajtja e rregullt e motorëve</b> - Servisimi periodik i makinerive ndihmon që motorët të punojnë në mënyrë të rregullt, duke zvogëluar emisionet e CO<sub>2</sub> dhe gazeve të tjera.</li> <li>• <b>Menaxhimi i mirë i orarit të punës</b> - Planifikimi i aktiviteteve në mënyrë që makineritë të përdoren vetëm kur është e domosdoshme zvogëlon kohën e funksionimit të panevojshëm, ul konsumin e karburantit dhe redukton ndotjen e ajrit.</li> <li>• <b>Përdorimi i shpejtësive të ulëta brenda impiantit</b> - Makineritë lëvizin me shpejtësi të kufizuar, duke ulur konsumin e karburantit dhe emisionet e gazeve.</li> <li>• <b>Kufizimi i punimeve në kushte të pafavorshme</b> - Gjatë periudhave me erë të fortë ose temperatura shumë të larta, puna organizohet me kujdes për të shmangur konsum të tepërt të karburantit.</li> </ul>
-------	--	---

<b>5. UJI</b>		
5.1.	Të dhënat për shfrytëzimin e ujit	Në kuadër të funksionimit të impiantit për separimin e rërës dhe zhavorrit, uji shfrytëzohet vetëm për qëllime të kontrollit të pluhurit, respektivisht për ujitjen e sipërfaqeve të punës dhe rrugëve të brendshme. Uji i përdorur për këtë qëllim sigurohet përmes cisternës dhe nuk merret nga burime natyrore sipërfaqësore apo nëntokësore në lokacionin e impiantit.
5.2.	Të dhënat për shkarkimin e ujërave, shkarkimet e ujërave sipërfaqësore apo në rrjetin e kanalizimit	Impianti për seperimin e rërës dhe zhavorrit nuk ka shkarkim të ujit.
5.3.	Ndikimet në ujë	Veprimtaria e impiantit për separimin e rërës dhe zhavorrit nuk krijon ndikim të drejtpërdrejtë në ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore, pasi gjatë procesit teknologjik nuk bëhet përdorim i ujit dhe nuk realizohet shkarkim i ujërave të ndotura. Procesi i përpunimit është plotësisht mekanik dhe

		<p>zhvillohet në kushte të thata, pa gjeneruar rrjedhje apo përzierje që mund të ndikojnë në cilësinë e ujit. Uji shfrytëzohet vetëm për spërkatjen e sipërfaqeve të punës me qëllim zvogëlimin e pluhurit. Ky ujë sigurohet nga cisterna dhe përdoret në mënyrë të kontrolluar, pa pasur kontakt me materiale ndotëse dhe pa krijuar ujëra të ndotura që do të kërkonin trajtim ose shkarkim. Në afërsi të lokacionit gjenden rrjedha ujore, përfshirë Lumin Krivarekë dhe Lumin Morava e Binçës, megjithatë për shkak të mungesës së shkarkimeve ujore dhe zhvillimit të aktivitetit në sipërfaqe të thata, nuk pritët ndikim në cilësinë e ujërave sipërfaqësore dhe as në ujërat nëntokësore. Pajisjet dhe makineritë e impiantit mirëmbahen rregullisht për të parandaluar rrjedhje të vajrave dhe karburanteve. Këto masa zvogëlojnë rrezikun e ndotjes së tokës dhe të infiltrimit të substancave ndotëse në ujërat nëntokësore. Bazuar në këto kushte, ndikimi i veprimtarisë së impiantit në regjimin dhe cilësinë e ujërave vlerësohet si i ulët dhe i pranueshëm nga aspekti mjedisor.</p>
5.4.	Emisionet e ujërave të ndotura - treguesi i emisioneve kryesor	<p>Në impiantin e seperimit të rërës dhe zhavorrit nuk krijohen ujëra të ndotura teknologjike, pasi gjatë procesit nuk përdoret ujë në linjën e prodhimit dhe nuk ka rrjedhje të ujit që mund të përfshijë ndotës. Uji përdoret vetëm për spërkatje të sipërfaqeve me qëllim zvogëlimin e pluhurit, dhe merret nga cisterna. Për këtë arsye, treguesi kryesor i emisioneve nga ujërat është niveli zero, pra mungesa e shkarkimit të ujërave të ndotura. Kjo do të thotë se:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Nuk ka prani të lëndëve të pezulluara</li> <li>• Nuk ka vajra apo karburante në ujë</li> <li>• Nuk ka ndotës kimikë</li> <li>• Nuk ka rrjedhje teknologjike në tokë ose në ujërat nëntokësore</li> <li>• Nuk ka nevojë për trajtim të ujit të shkarkuar, pasi shkarkim nuk ekziston</li> </ul>
5.5	Trajtimi i ujërave tëndotura	Në impiantin e seperimit të rërës dhe zhavorrit nuk është e nevojshme trajtimi i ujit pasi nuk ka shkarkim të ujit.
5.6.	Kontrolli dhe matjet	Nuk është e nevojshme të bëhet kontrolli dhe matjet e ujërave pasi nuk ka shkarkim të ujërave.

5.7.	Raportimi	Nuk është i nevojshëm
5.8.	Leje Ujore për shfrytëzim të ujit	Nuk është i nevojshëm
5.9.	Leje Ujore për shkarkimin e ujërave	Nuk është i nevojshëm
5.10.	Masat për zvogëlimin e ndotjes së ujërave	Në impiantin e seperimit të rërë dhe zhavorrit nuk krijohen ujëra të ndotura teknologjike dhe nuk ka asnjë shkarkim të ujit në terren. Uji përdoret vetëm për spërkatje, dhe merret nga cisterna. Për shkak se uji nuk hyn në procesin e prodhimit dhe nuk ka kontakt me materiale ndotëse, nuk paraqitet rrezik për ndotje të ujërave sipërfaqësore apo nëntokësore. Për këtë arsye, veprimtaria nuk kërkon masa të veçanta për mbrojtjen e ujërave, pasi nuk krijohen ujëra të ndotura dhe nuk ka shkarkime që mund të ndikojnë në mjedis.

<b>6. ZHURMA</b>		
6.1.	Burimet	Në impiantin e seperimit të rërës dhe zhavorrit, zhurma krijohet kryesisht nga sita vibruese, rripat bartës dhe makineritë që përdoren gjatë ngarkimit e lëvizjes së materialit. Këto janë burime të zakonshme të zhurmës për këtë lloj veprimtarie. Shtëpitë më të afërta ndodhen në një distancë më të madhe se 655 metra nga impianti, prandaj zhurma nuk paraqet ndikim për zonat e banuara dhe nuk krijon shqetësime për popullatën.
6.2.	Kontrolli dhe matjet	Duhet të bëhen matjet e zhurmës në përputhje me ligjet dhe rregullat mbi mbrojtjen nga zhurma. Matjet duhet bërë në afërsi të objekteve të banimit. Për vlerësimin e rezultateve të fituara nga matjet duhet ti krahasojmë me vlerat e lejuara me standarde për vendet ku jetojnë dhe punojnë njerëzit.
6.3.	Raportimet	Raportimi i zhurmës do të bëhet sipas kushteve që do të dalin nga leja mjedisore, do të bëhet matja dhe do të raportohet në MMPHI.

7. TOKA		
7.1.	Ndikimet në tokë	Veprimtaria e impiantit zhvillohet në një sipërfaqe të rrafshuar dhe të përgatitur për punë, prandaj ndikimet në tokë janë të kufizuara. Procesi nuk përdor ujë teknologjik dhe nuk krijon shkarkime që mund të depërtojnë në tokë. E vetmja ngarkesë mbi sipërfaqe vjen nga lëvizja e makinerive dhe vendosja e materialit të papërpunuar, që është natyrshëm pjesë e këtij aktiviteti. Rreziku kryesor potencial për tokën lidhet me rrjedhjet e mundshme të vajrave ose karburanteve nga makineritë, por me mirëmbajtje të rregullt dhe kontroll të pajisjeve ky rrezik është i ulët. Për shkak se materiali që trajtohet është rërë dhe zhavor, nuk krijohen mbetje që mund të ndikojnë në cilësinë e tokës. Në përgjithësi, ndikimi i impiantit në tokë konsiderohet i vogël dhe nuk shkakton ndryshime të qëndrueshme në strukturën ose cilësinë e saj.
7.2.	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në tokë	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në tokë janë: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ruajtja e materialit të papërpunuar dhe të përpunuar në zona të rregulluara, të shtruara dhe të mbuluara sipas nevojës, për të shmangur shpërndarjen e pluhurit dhe përzierjen me tokën.</li> <li>• Mirëmbajtja e rrugëve të brendshme për të zvogëluar erozionin dhe ngritjen e materialeve në ajër.</li> <li>• Menaxhimi i derdhjeve eventuale të vajrave ose lëngjeve teknike me materiale absorbues dhe largimi i tyre sipas rregullave.</li> <li>• Kufizimi i zonave të punës vetëm brenda sipërfaqes së lejuar për të shmangur degradimin e tokës përreth.</li> <li>• Vendosja e sinjalistikës dhe barrierave për mbrojtjen e sipërfaqeve jashtë zonës operative.</li> </ul>
7.3.	Përshkrimi i rehabilitimit të zonës pas përfundimit të aktivitetit	Pas përfundimit të aktivitetit të impiantit të seperimit të rërës dhe zhavorrit, zona i nënshtrohet një procesi të plotë rehabilitimi me qëllim rikthimin e saj në një gjendje të sigurt, të qëndrueshme dhe vizualisht të pranueshme. Rehabilitimi kryhet në disa faza që sigurojnë që terreni të mos mbetet i dëmtuar dhe të jetë i përshtatshëm për përdorime të ardhshme. <b>Heqja e pajisjeve dhe pastrimi i zonës</b> - Në fazën e parë të rehabilitimit hiqen të gjitha pajisjet e impiantit. Zona pastrohet nga mbetjet e procesit

dhe nga materialet e papërdorshme, duke u siguruar që sipërfaqja të mbetet e lirë nga objekte të huaja.

**Rrafshimi dhe stabilizimi i sipërfaqes** - Pasi të largohen pajisjet, sipërfaqja e punës rrafshohet për të eliminuar gropat, shtresimet e pabarabarta dhe gjurmët e makinerive. Qëllimi është që terreni të marrë një formë të rregullt dhe të jetë i qëndrueshëm në aspektin fizik. Në zonat ku toka është ngjeshur, kryhet hapja dhe përgatitja e saj në mënyrë që të sigurohet ajrosja dhe shmangia e erozionit.

**Vendosja e tokës vegetative** - Në sipërfaqet e rrafshuara vendoset një shtresë toke vegetative, e përshtatshme për rigjenerimin e bimësisë lokale. Kjo shtresë është e rëndësishme për kthimin gradual të zonës në funksion natyror dhe për stabilizimin afatgjatë të terrenit.

**Rikthimi i bimësisë natyrore** - Pas vendosjes së tokës vegetative, fillon procesi i rritjes së bimësisë së ulët, e cila ndihmon në përmirësimin e pamjes së përgjithshme të zonës dhe në mbrojtjen e tokës nga erozioni. Bimësia rigjenerohet natyrshëm në pjesën më të madhe, duke u bazuar në speciet e zakonshme të zonës.

**Stabiliteti mjedisor dhe parandalimi i ndotjes** - Gjatë të gjithë procesit të rehabilitimit sigurohet që të mos ketë ndikim në tokë, ujëra ose ajër. Nuk përdoren materiale që mund të shkaktojnë ndotje. Meqenëse aktiviteti i impiantit nuk ka shkarkime uji dhe nuk krijon mbetje të rrezikshme, rehabilitimi kryhet lehtë dhe pa rrezik mjedisor.

**Rikthimi i zonës në funksion natyror** - Qëllimi final është që pas përfundimit të aktiviteteve, zona të kthehet në një gjendje sa më natyrale, të sigurt dhe të qëndrueshme, pa rreziqe për mjedisin dhe pa mbetje të qëndrueshme të aktivitetit teknologjik.

## 8. MENAXHIMI I MBETURINAVE

8.1.	Përshkrimi i llojit të mbeturinave dhe klasifikimi sipas katalogut shtetëror të mbeturinave	Llojet e Mbeturinave të cilat krijohen janë: Mbeturina të ngurta komunale të cilat grumbullohen dhe vendosen në kontejnerë të posaçëm të pajisur me kapak për mbulim me qëllim të mbrojtjes së tokës dhe ujërave nëntokësor.			
		<b>Mbeturina</b>	<b>Emri i mbeturinës</b>	<b>Shkalla rrezikshmëri së</b>	<b>Lloji i deponimit</b>
		20 01 08	Mbeturinat E ngurta komunale	Jo të rrezikshme	Kontejner për mbeturina
		Përpos mbeturinave komunale dhe të ngjashme nuk gjenerohen mebturina tjera			
8.2.	Përshkrimi i Magazinimit apo deponimit të mbeturinave	Mbeturinat e ngurta komunale grumbullohen dhe vendosen në kontejnerë të posaçëm të pajisur me kapak për mbulim dhe merren nga kompania e pastimit. Mbeturina tjera nuk gjenerohen			
8.3.	Përshkrimi për trajtim, përpunim dhe riciklimi të mbeturinave	Gjatë aktivitetit të impiantit të seperimit të rërës dhe zhavorrit nuk bëhet përpunim dhe riciklim i mbeturinave.			
8.4.	Dërgimi për trajtim dhe riciklim te operatori tjetër – kontrate me kompaninë me leje përkatëse	Impianti i seperimit të rërës dhe zhavorrit nuk i dërgon te operatorët tjer për riciklim			
8.5.	Plani për menaxhimin e mbeturinave	Impianti i seperimit të rërës dhe zhavorrit nuk ka plan për menaxhimin e mbeturinave.			
8.6.	Raportimi	Nuk bëhet raportimi			

## 9. RREZIKU NGA AKSIDENTET

9.1.	Plani për pengimin e aksidenteve ne rast të rrezikut/ plani i intervenimit të brendshëm dhe të jashtëm	Kompania “ <b>Agi - Dani</b> ” SH.P.K., e cila ushtron veprimtari në fushën e seperimit të rërës dhe zhavorrit, nuk posedon Plan për Pengimin e Aksidenteve në Rast të Rrezikut dhe Plan të Intervenimit të Brendshëm dhe të Jashtëm, pasi aktiviteti nuk përfshin përdorimin apo trajtimin e substancave të rrezikshme dhe nuk klasifikohet si veprimtari me rrezik të lartë teknologjik apo industrial.
9.2.	Përdorimi i substancave të rrezikshme kimike dhe preparateve, planifikimi i masave për zëvendësimin e tyre.	Kompania “ <b>Agi - Dani</b> ” SH.P.K., nuk përdor substanca kimike të rrezikshme apo preparate të ngjashme gjatë procesit teknologjik të përpunimit, thërrmimit dhe seperimit të rërës dhe zhavorrit. Procesi operativ është i natyrës mekanike dhe fizikisht i kontrollueshëm, pa përfshirë komponentë me rrezik të lartë për shëndetin e njerëzve apo për mjedisin.
9.3.	Masat për parandalimin e aksidenteve dhe zvogëlimi i pasojave	Edhe pse procesi nuk përdor substanca kimike, kompania zbaton masa të rrepta sigurie për të parandaluar aksidentet dhe për të ulur pasojat e mundshme. Punonjësit trajnohen rregullisht për përdorimin e sigurt të makinerive dhe pajisjeve. Zona e punës mbahet e organizuar dhe e sinjalizuar, me korridore të qarta lëvizjeje dhe me kontroll të qarkullimit të mjeteve. Makineritë mirëmbahen sipas planit periodik për të shmangur defektet dhe situatat e rrezikshme. Punonjësit pajisen me pajisje personale mbrojtëse si helmetë, veshje pune, doreza dhe mbrojtëse të veshëve. Në rast të ngjarjeve të papritura, në vend punishte janë të vendosura mjete të emergjencës, kutia e ndihmës së parë dhe shtegun e evakuimit. Këto masa sigurojnë që rreziku i aksidenteve të jetë minimal dhe ndikimi i tyre të zvogëlohet ndjeshëm.
9.4.	Raporti mbi gjendjen e sigurisë	Kompania “ <b>Agi - Dani</b> ” SH.P.K., nuk posedon rezervuar për deponimin e lëndëve djegëse si nafta apo benzinë, për shkak se në kuadër të aktivitetit të saj nuk parashikohet përdorimi apo ruajtja afatgjatë e këtyre substancave, prandaj kompania nuk ka hartuar Raport mbi Gjendjen e Sigurisë.
9.5.	Plani për mbrojtjen nga zjarri	Kompania “ <b>Agi - Dani</b> ” SH.P.K., nuk ka të hartuar Planin për Mbrojtjen nga Zjarri, pasi natyra e aktivitetit nuk përfshin materiale të djegshme apo substanca me rrezik të lartë zjarri.

## 10. MASAT NË RASTET E PUNES JO STABILE TË IMPIANTIT

10.1.	Ndërprerja momentale e punës së impiantit	Nuk ka ndërprerja momentale të punës.
10.2.	Ndërprerja e punës	Ndërprerja e punës nuk ka

## 11. NDIKIMI I MUNDSHËM I NDOTJES NË SHENDETIN E NJERIUT

Gjatë funksionimit të vazhdueshëm të kompanisë “ **Agi - Dani** ” **SH.P.K.**, e cila ushtron aktivitetin në zonën kadastrale Domorovc, Komuna e Ranillugës, me fokus seperimin e rërës dhe zhavorrit, ndikimi i mundshëm në shëndetin e njeriut konsiderohet shumë i vogël. Procesi teknologjik është i natyrës mekanike dhe zhvillohet në ambient të hapur, pa përfshirje të substancave të rrezikshme kimike apo ndotësve të dëmshëm për shëndetin publik. Të gjitha pajisjet që përdoren në proces (sita, mjete transporti) janë të mirëmbajtura dhe funksionojnë në përputhje me standarde teknike dhe të sigurisë, duke siguruar kontroll të duhur mbi zhurmën, pluhurin dhe ndotjet e mundshme difuzive. Për më tepër, vendndodhja e objektit në distancë prej me shume se 655 metra nga objektet e banimit ndihmon në minimizimin e ekspozimit të komunitetit përreth ndaj ndonjë ndikimi të drejtpërdrejtë. Bazuar në këto faktorë, veprimtaria nuk përbën rrezik për shëndetin e njeriut.

### Personi Përgjegjës për Mjedis

#### Emri Mbiemri

Halit Bajraliu

#### Nënshkrimi

---

### Personi përgjegjës i Kompanisë

#### Emri Mbiemri

Rexhep Veseli

#### Nënshkrimi

---